



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 18, Datë 31.01.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SH.P.K., NR. 276, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 37, DATË 18.03.2015.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 24/2 Prot, datë 24.01.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 Prot, datë 17.01.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 04.11.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42304017T.
- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet : Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Konstatohet se shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formatimi dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të pjercellë jo në formën e parashikuar nga rregullorja, e që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 2

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
  - Do t’i kërkohet shoqërisë të paraqesë në ERE Vërtetimin e Gjykatës dhe të Prokurorisë për gjendjen gjyqësorë të përfaqësueses ligjore të shoqërisë.

Neni 9, pika 4.8

- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie)
  - Shoqëria ka deklaruar të njëjtin kapital financiar për qëllime të aplikimeve për rinovimin e licencës së tregtimit dhe të furnizimit. Do t’i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e secilës veprimtari më vete.
- **gërma “c”** (Lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur).
  - Shoqëria në plotësim të kësaj kërkesë të rregullores ka listuar disa data kontratash, por pa të dhënat përkatëse të këtyre kontratave.

*Për sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.*

- Rezulton se shoqëria aplikuese nuk është debitore sa i përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 276, Seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 37, datë 18.03.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 19.03.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**